

Pila të certifikuara nga ATEX



MANUALI I PËRDORUESIT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Të dhënat e klasifikimit.....	4
Shënime sigurie.....	5
Etiketimi dhe fusha e aplikimit	5
Montimi	6
Vënia në punë	6
Operimi dhe vënia në punë.....	7
Mirëmbajtja dhe riparimet	7
Shënimet normative që duhen mbajtur parasysh (ekstrakt)	8

HYRJE

Informacioni që ndodhet në këtë dokument është shumë i rëndësishëm për trajtimin dhe përdorimin e duhur të pilave të certifikuara nga ATEX. Ai përmban specifikime globale të sistemit, si dhe masat përkatëse të sigurisë, kodet e sjelljes, një udhëzues për vënien në punë dhe mirëmbajtjen e rekomanduar. Ky dokument duhet të ruhet dhe të jetë i disponueshëm për përdoruesit që punojnë me baterinë dhe janë përgjegjës për të. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për t'u siguruar që të gjitha aplikimet e sistemit të jenë të përshtatshme dhe të sigurta, bazuar në kushtet e parashikuara ose të hasura gjatë përdorimit.

Ky manual përdorimi përmban udhëzime të rëndësishme sigurie. Lexoni dhe kuptoni seksionet për sigurinë dhe funksionimin e baterisë para se të përdorni baterinë dhe pajisjet në të cilat është instaluar.

Është përgjegjësi e zotëruesit të sigurojë që përdorimi i këtij dokumentacioni dhe të gjitha aktivitetet e lidhura janë në përputhje me kërkesat ligjore të zbatueshme në vendet e tyre përkatëse.

Ky manual përdorimi nuk ka për qëllim të zëvendësojë asnjë trajnim lidhur me trajtimin dhe përdorimin e pilave të certifikuara nga ATEX që mund të kërkojnë nga ligjet vendore dhe/ose standardet e industrisë. Duhet të sigurohen udhëzimet dhe trajnimi i duhur i të gjithë përdoruesve përpara çdo kontakti me sistemin e baterisë.

Për shërbime, kontaktoni përfaqësuesin tuaj të shitjeve ose telefononi:

EnerSys EMEA
EH Europe GmbH
Baarerstrasse 18
6300 Zug, Zvicër
Tel: +41 44 215 74 10

EnerSys World Headquarters
2366 Bernville Road
Reading, PA 19605, SHBA
Tel: +1-610-208-1991
+1-800-538-3627

EnerSys APAC
No. 85, Tuas Avenue 1
Singapore 639518
+65 6558 7333
www.enersys.com

Siguria juaj dhe siguria e të tjerëve është shumë e rëndësishme

⚠ PARALAJMËRIM Mund të vriteni ose të plagoseni rëndë nëse nuk ndiqni këto udhëzime.

INFORMACION

Deklarata e pajtueshmërisë e KE

Pila Ex për bateri automjesh

Me anë të këtij dokumenti, EnerSys® konfirmon se këto pila (shihni më poshtë për përshkrimin me numrin e serisë dhe numrin e certifikatës së ekzaminimit të tipit EC, shërbimin e certifikimit SIRA, numrine e organit të njoftuar 2813) i përmbahen Direktivës 2014/34/EU për Pajisjet dhe Sistemet Mbrojtëse për Përdorim në Zonat me Rrezik Shpërthimi. Kërkesat themelore për shëndetin dhe sigurinë plotësohen duke iu përmbajtur normave: DIN EN 60079-0, DIN EN 60079-7, DIN EN 60079-31, IEC 61241-0 dhe IEC 61241-1.

Nënshkruar: _____ (Menaxheri i autorizuar i ATEX/IECEx)

Nr. i serisë: _____

Tipi i pilës Ex: _____

Certifikata e ekzaminimit të tipit EC: SIRA 01 ATEX 30 _____ U

Certifikata e konformitetit IECEx: IECEx SIR 07.006 _____ U

Kjo deklaratë është në përputhje me direktivat e mësipërme por nuk përmban garanci të karakteristikave sipas kuptimit ligjor. Shënimet e sigurisë të dokumentacionit të dhënë të produktit duhet të zbatohen.

Ky manual përdorimi përmban shënime për montimin dhe përdorimin e sigurit të pilave Ex në bateritë e automjeteve.

Pilat Ex janë komponentë të përkufizuar brenda Direktivës 2014/34/EU (ATEX/IECEx).

Për prodhimin dhe përdorimin si bateri, duhet të plotësohen kërkesat te mëtejshme të Direktivës, të cilat nuk mbulohen nga certifikimi i komponentëve të pilave dhe nuk mbulohen nga përmbajtja e këtij manuali përdorimi.

Shënime sigurie

Nuk lejohet përdorimi i modeleve të ndryshme të pilave brenda një baterie. Kjo vlen gjithashtu për madhësitë që kanë të njëjtin tip, performancë dhe kapacitet.

Pilat Ex plotësojnë kërkesat e sigurisë në rastin e përdorimit të synuar.

Rregullat dhe kushtet e veçanta për aplikimin e sigurt sipas numrit të certifikatës të ekzaminimit të tipit EC:

Numri i konformitetit të certifikatës SIRA 01ATEX3016U, SIRA 01ATEX3019U, SIRA 03ATEX3087U, SIRA 03ATEX3090U dhe IECEx: IECEx SIR07.0061U, IECEx SIR07.0062U, IECEx SIR07.0063U, IECEx SIR07.0064U duhet plotësuar.

Nëse pilat janë ndërtar të gjitha së bashku si bateri, duhet të zbatohen të paktën kushtet e përcaktuara në DIN EN 60079-7:

- Informacion i përgjithshëm
- Kontejner i baterisë
- Pilat
- Konektor
- Karikimi i pilave
- Shkarkimi i pilave
- Duke përfshirë llojet e tjera të ndezjes
- Fikja dhe transporti
- Bateri dytësore
- Rezistenca e izolimit
- Testi i goditjeve
- Ajrimi

Etiketimi dhe fusha e aplikimit

Ky manual përdorimi vlen për pilat pas certifikatës së ekzaminimit të tipit EC dhe numrit të konformitetit të certifikatës IECEx:

- IECEx SIR07.0061U—SIRA 01ATEX3016U Type B Lead Acid Motive Power cells (PzB, PzMB)
- IECEx SIR07.0062U—SIRA 01ATEX3019U Type D Lead Acid Motive Power cells (PzS, PzM)
- IECEx SIR07.0063U—SIRA 03ATEX3087U Type B Evolution® Lead Acid Motive Power cells (PzVB)
- IECEx SIR07.0064U—SIRA 03ATEX3090U Type D Evolution® Lead Acid Motive Power cells (PzV) dhe NexSys® TPPL cells (NxS)

Shkronja U pas numrit të certifikatës tregon se kjo certifikatë nuk duhet të ngatërrohet me një certifikatë që është bërë për një pajisje ose sistem mbrojtës. Kjo certifikatë komponenti mund të përdoret vetëm si bazë për një certifikim të pajisjes ose sistemit mbrojtës. Prandaj, certifikatat që tregohen i referohen vetëm konceptit dhe testimit të tipit të pilave të komponentit të specifikuar në përputhje me

Direktivën 2014/34/EU. Për të prodhuar dhe qarkulluar pilat, prodhuesi duhet të plotësojë kërkesat e tjera të Direktivës, të cilat nuk mbulohen nga këto certifikata.

Kjo bën të lindë nevoja që një punë instalimi përfundimtar duhet të ketë plotësuar kërkesat si një biznes dhe person që ka certifikimin ATEX dhe IECEx.

M2 Ex eb I
II 2G Ex eb IICT6 II 2D Ex IICT80°C
Ex eb I
Ex eb IICT6
Ex tb IICT80°C



Këto pila Ex mund të përdoren vetëm në fushat e mëposhtme:

- Grup shpërthimi I Kategoria M2/Mb minierë
- Grup shpërthimi II Kategoria 2 dhe 3 [Zona 1 2G/Gb, Zona 2 3G/Gc (Gaz)]
- Grup shpërthimi III Kategoria 2 dhe 3 [Zona 21 D/Db, Zona 22 3D/Dc (Pluhur)]

MONTIMI DHE VËNIA NË PUNË

Montimi

Kur montohen, pilat duhet të ngrihen gjithnjë nga të gjitha postet njëkohësisht me pajisje ngritëse të izoluar.

Pilat Ex mund të lidhen vetëm në një rresht (lidhje në seri). Nuk lejohet lidhja paralele. Gjatë montimit, duhet respektuar polariteti i duhur. Për instalimin elektrik, mund të përdoren vetëm komponentët e autorizuar nga EnerSys®. Sistemi opsional aquamatic dhe qarkullimi i elektrolitit duhet të instalohen sipas kërkesave të EnerSys, pra "në pajtueshmëri me instalimin elektrik". Kërkoni informacionin përkatës, nëse nevojitet.

SHËNIM: Teknologjia e lidhjes, sistemi aquamatic, dhe qarkullimi i elektrolitit janë pjesë e testimit dhe miratimit të komponentit të pilave, ndaj nuk duhen modifikuar.

Të gjithë komponentët duhet të merren nga EnerSys.

Gjithashtu, lidhjet fundore dhe heqjet e ndërmjetme mund të kryhen vetëm komponentë të miratuar. Duhet të përdoren vida M 10 x 20 të reja, të papërdorura me kyçjen e specifikuar të

vidës : forca e shtrëngimit 25 + 2 Nm! Është e detyrueshme të siguroni kontaktin dhe kapjen e duhur të filetave.

Lidhjet me kapakun duhen shtrënguar. Për të garantuar mbrojtjen IP, duhet të përdoret një kapak që nuk ka asanjë vrimë.

Kur përdorni kapakë konektori me një vrimë, (vetëm në polin negativ për matjen e tensionit), dhoma e konektorit duhet të mbushet me graso, si për shembull Berutoz M 21 KN.

Komponentët elektronikë nuk mund të përdoren pranë një baterie ATEX/IECEx, si për shembull poshtë ndonjë kapaku ose pranë pilës.

Vetëm pilat Ex që kanë të njëjtin tip, madhësi dhe kapacitet mund të lidhen së bashku.

Pilat Ex duhet të instalohen fort te kontejneri i baterisë. Çdo hapësirë e mundshme duhet të mbushet me material mbushës stabil rezistent ndaj acidit. Përdorimi i kutive të pilave ose materialit mbushës ngjashëm shkumës nuk lejohet.

Vënia në punë

Për vënien në punë të pilave Ex, duhet të zbatoni manualin e përdorimit për Perfect Plus™, Water Less®, Evolution® ose NexSys®TPPL (shiko www.enersys.com).

Përveç kësaj, zbatohet manuali i përdorimit të pajisjes ose sistemit mbrojtës, në të cilin janë integruar këto pila Ex.

Pilat me acid plumbi, në veçanti pilat e përmbytura, mund të ruhen vetëm për një kohë të kufizuar nëse nuk karikohen rregullisht. Pilat e reja duhet të jenë të karikuara plotësisht kur dorëzohen. Pilat Perfect Plus™ dhe Water Less® duhet të karikohen të paktën çdo 6 javë, pilat Evolution® dhe NexSys®TPPL duhet të karikohen brenda 3 muajsh.

Kur montoni sërish bateritë, vetëm pilat që kanë të njëjtën gjendje karikimi dhe pilat që kanë etiketimin ATEX duhet të lidhen së bashku. Tensioni i qarkut të hapur i pilave duhet të jetë të paktën 2.13 V/pilë në gjendje të karikuar plotësisht.

Përdorimi dhe karikimi

Mos e karikoni asnjëherë baterinë ose pilat Ex në një vend të zonuar njëherësh.

Për karikimin dhe përdorimin, mund të përdoret manuali i përdorimit të ndërtimit të baterisë (shiko www.enersys.com). Përveç kësaj, zbatohet manuali i përdorimit të pajisjes ose sistemit mbrojtës, në të cilin janë integruar këto pila Ex.

Vlerat e identifikimit të pilave Ex:

Tensioni nominal maksimal i lejuar në sistemin e baterive:	500 V
Gama e temperaturës së ambientit:	-20 deri në 40 °C
Temperatura maksimale e lejuar e pilave të baterisë:	55 °C
Rryma nominale:	0.2 C ₅

Caktimi:

Kapaciteti nominal C ₅		Ndër-seksioni i lidhjes	Rryma nominale
deri në	315 Ah	25 mm ²	63 A
deri në	440 Ah	35 mm ²	88 A
deri në	630 Ah	50 mm ²	126 A
deri në	880 Ah	70 mm ²	176 A
deri në	1550 Ah	95 mm ²	310 A

Vetëm pajisjet e miratuara të karikimit dhe karakteristikat e miratuara të karikimit mund të përdoren. Kur integroni pajisjet e karikimit në automjet dhe kur karikoni bateritë në vende ku ekziston rreziku i shpërthimit, sistemi i karikimit duhet të integrohet duke iu përmbajtur standardit DIN EN 60079-7.

Bateritë që kanë arritur temperaturë më të lartë se 40 °C në fund të karikimit, duhet të ftohen nën 40 °C para se të përdoren në vende ku ekziston rreziku i shpërthimit.

Mirëmbajtja dhe riparimet

Mund të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale të miratuara nga EnerSys. Vetëm pilat që kanë etiketën ATEX të një prodhuesi me të njëjtin tip, madhësi dhe kapacitet mund të përdoren për ndërrim.


Përveç kësaj, zbatohet manuali i përdorimit të pajisjes ose sistemit mbrojtës, në të cilin janë integruar këto pila Ex.

Për të kryer këtë punë, duhet të zbatohen rregullat e EN 60079-19. Ripunimi duhet të kryhet vetëm nga personeli që ka kualifikimin e duhur dhe duhet të dokumentohet, dhe pajisja ose sistemi mbrojtës të identifikohet me një etiketë R përkatëse.


SHËNIME DHE HEDHJA

Shënime normative që duhen zbatuar (ekstrakt)

Direktiva	1999/92/EC
Direktiva	2014/34/EU
DIN EN 1127-1	Atmosferat shpërthyes—Parandalim dhe mbrojtje nga shpërthimi—Pjesa 1: Konceptet bazë dhe metodologjia
DIN EN 1175-1	Siguria e kamionëve industrialë—Kërkesat elektrike Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme për kamionët me bateri
DIN EN 60079-0	Atmosferat shpërthyes—Pjesa 0: Pajisjet—Kërkesa të përgjithshme.
DIN EN 60079-7	Atmosferat shpërthyes—Pjesa 7: Mbrojtja e pajisjeve me siguri të lartë “e”
DIN EN 60079-31	Atmosferat shpërthyes—Pjesa 19: Riparimi, rindërtimi dhe restaurimi i pajisjeve
DIN EN 61241-0	Pajisjet elektrike për t'u përdorur në praninë e pluhurave të djegshëm—Pjesa 0: Kërkesa të përgjithshme
DIN EN 61241-1	Pajisjet elektrike për t'u përdorur në praninë e pluhurave të djegshëm—Pjesa 1: Tipi i mbrojtjes “tD”
DIN EN 62485-3	Kërkesat e sigurisë për bateritë dytësore dhe instalimin e baterive—Pjesa 3: Bateritë tërheqëse



Bateria duhet të riciklohet



Bateritë për fuqi tërheqëse

Hidheni gjithnjë kontejnerin e baterive dhe pilat në depon lokale të shërbimit. Mos tentoni të çmontoni baterinë ose pilat në ndonjë mënyrë. Pasi produkti nuk funksionon më dhe nuk mund të riparohet më, mbajeni jashtë hapësirës së zonuar derisa të hiqet për restaurim.

Bateritë me këtë shenjë duhet të riciklohen.

Bateritë që nuk kthehen për proces riciklimi duhet të hidhen si mbetje të rrezikshme!

Kur përdorni bateri automjeti me fuqi dhe karikues, operatori duhet të përputhet me standardet aktuale, ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi në vendin e përdorimit!

Ky dokument është një përkthim nga versioni origjinal i publikuar në gjuhën angleze (https://www.enersys.com/4ace61/globalassets/documents/product-documentation/_enersys/emea/legacy/batteries/hawker/atex/emea-en-iu-haw-atex-0522.pdf).

Në rastin e mospërputhjes midis këtij versioni dhe origjinalit, do të mbizotërojë versioni në anglisht.

www.enersys.com

© 2025 EnerSys. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Markat tregtare dhe logot janë pronë e EnerSys dhe filialeve të saj, nëse nuk specifikohet ndryshe. Objekt i rishikimit pa njoftim paraprak. E.&O.E.

EMEA-SQ-OM-ATEX-CELL-0725

EnerSys[®]

Power/Full Solutions